



**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS**

PUNIM DIPLOME

**PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE
BACHELOR SHKENCAT JURIDIKE NË BIZNËS**

Prokurimet Publike në procesin e Integritimit.

Elbasan 2023

Udhëheqës : Prof.as.dr Arbër GJETA.

Studente : Esmeralda ÇEHU

ABSTRAKTI

Synimi i këtij punimi bachelor është të trajtojë temën në lidhje me prokurimet publike në Shqipëri me synimin e analizimit të sfidave me të cilat përballen për arritjen e transparencies efikasitetit dhe zbatimin e ligjeve.

Studimi fillon duke shqyrtuar parimet themelore dhe kornizat ligjore që rregullojnë praktikën e prokurimit publik në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Jepen shembuj të rasteve konkrete duke nxjerr në pah rastet të zbatimeve të suksesshme të prokurimit, si dhe rastet që nuk kanë arritur pritshmëritë.

Hulumtimi për këtë temë diplome eksploron gjithashtu rolin e teknologjisë në vendimarrjen dhe përzgjedhjen e subjekteve, minimizimin e rreziqeve të korrupsionit.

Në qendër të kësaj analize është krahasimi i politikave shqiptare të prokurimit me parimet e përcaktuara nga Bashkimi Evropian. Studimi sqaron se si harmonizimi i këtyre praktikave me standardet e BE-së mund të çojë në rritjen e transparencës, konkurrencës dhe efikasitetit në shpenzimet publike. Ai thellohet në përfitimet dhe sfidat e përafrimit me BE-në, duke marrë parasysh faktorë të tillë si ndërtimi i kapaciteteve, bashkëpunimi institucional dhe potenciali për të hyrë në një grup më të gjerë furnizuesish.

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT / AUTORËSISË

Ky punim diplome i nivelit bachelor me temë “Prokurimet Publike në procesin e integritetit”, e paraqitur si kërkesë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Fakulteti ekonomik, (Shkenca Juridike në Biznës) deklaroj se është puna ime origjinale.

Dëshmoj se kjo punë nuk është dorëzuar më parë për ndonjë kualifikim apo diplomë akademike në asnjë institucion tjetër. Gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe shkrimit, unë i kam respektuar parimet dhe udhëzimet etike për integritetin akademik. Të gjitha burimet dhe referencat e përdorura në këtë punë janë cituar dhe pranuar siç duhet. Çdo tekst, ide ose koncept i marrë nga burime të tjera është atribuar siç duhet. Më tej deklaroj se të dhënat, rastet studimore dhe shembujt e paraqitur në këtë punim janë të sakta dhe përfaqësojnë informacionin e marrë gjatë procesit të kërkimit. Çdo mendim apo interpretim i shprehur në këtë punë është vetëm i imi dhe mbështetet nga provat e paraqitura.

Unë pasojat e plagjiaturës dhe marr përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e kësaj teme të diplomës. Jam e vetëdijshëm se çdo shkelje e standardeve etike mund të çojë në pasoja të rënda, duke përfshirë anulimin e diplomës sime dhe dënime të tjera përkatëse.

Unë e pranoj udhëzimin dhe mbështetjen e marrë nga mbikëqyrësi im, Prof.as.dr Arbër GJETA, gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe shkrimit. Vështrimet dhe komentet e tij kanë qenë të rëndësishme në formësimin e përmbajtjes dhe cilësisë së kësaj punë.

Me nënshkrimin e kësaj deklarate, unë pohoj përkushtimin tim për integritetin akademik dhe parimet e origjinalitetit dhe kërkimit etik.

FALENDERIME

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të përzemërt për të gjithë ata që kanë mbështetur dhe kontribuar në përfundimin me sukses të punimit tim të diplomës.

Para së gjithash, i jam jashtëzakonisht mirënjohëse mbikëqyrësit tim, Prof.as.dr Arbër GJETA për udhëzimet, ekspertizën dhe mbështetjen e pafund gjatë gjithë këtij udhëtimi kërkimor. Ku fal syrit kritik , argumentat dhe njohuria e pafund të këtij njeriu ka sjellë edhe rritjen e cilësisë dhe origjinalitetit të kësaj teme diplome.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI	2
DEKLARATA E ORIGJINALITETIT / AUTORËSISË	3
FALENDERIME	4
PËRMBAJTJA	5
LISTA E SHKURTIMEVE	6
HYRJE	7
KAPITULLI I : PROKURIMI PUBLIK	8
1.1 Prokurimi publik.	8
1.2 Roli i prokurimit publik.	9
1.2 Rëndësia e prokurimit publik.	9
1.3 Problematikat e Prokurimit Publik.....	9
Kapitulli II.Karakteristikat kryesore të prokurimit publik.	11
2.1 Karakteristikat e Prokurimit Publik.	11
2.2 Kuadri Ligjor i Prokurimit Publik	12
2.3 Institucionët përgjegjës për këto fusha janë:	13
Kapitulli III Proçesi i Integritit	17
3.1 Direktivat	17
3.1.2 Direktivat e para të Koordinimit.....	18
3.2 Legjislacioni European dhe prokurimi publik.	18
3.2.1 Planet kombëtare të Shqipërisë në proçesin e integritit.....	20
3.2.2 Raporti i Komisionit European për Shqipërinë, date 19.10.2021:	20
Kapitulli IV Sistemi elektronik i prokurimit publik	21
4.1 E-prokurim	21
4.1.1 Impakti i sistemit elektronik te prokurimit publik.....	22
4.1.2 Përmirësimet e nevojshme për sistemin e-prokurimit.	22
KONKLuzionET	23
REFERENCAT	25

LISTA E SHKURTIMEVE

BE- Bashkimi European

KLSH- Këshilli i Lartë European

SELDI-South-East Europe Leadership for Development and Integrity

OSBE-Organization of State Broadcasting Executive

Agjencia e Prokurimit Publik (APP)

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP)

Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP)

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara (ASHPP)

PPP-Partneriteti Publik Privat

SEPP- Sistemi Elektronik I Prokurimit Publik

HYRJE

Prokurimet publike në Shqipëri i referohen procesit në të cilin entet shtetërore dhe institucionët publike kryejnë përzgjedhjen nga autoritetet kontraktore me anën e konkurimit publik ku gjatë viteve janë bërë modifikime dhe përshtatje. Tema e diplomës hedh në qendër të vëmendjes fushën e prokurimit publik, duke zbuluar rëndësinë, sfidat dhe ndikimin e tij në zhvillimin e Shqipërisë.

Në kapitullin e parë paraqes sesi ligji kryesor është miratuar dhe ndryshimet që ka hasuar gjatë procedurave të përshtatjes me direktivat e Bashkimit Europian për prokurimin publik. Ky ligj përshkruan parimet dhe rregullat e përgjithshme që rregullojnë prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve nga autoritetet dhe subjektet publike. Karakteristikat kryesore që theksohen janë ato të transparencën, konkurrencën, mosdiskriminim dhe efikasitetin në proceset e prokurimit publik.

Në kapitullin e dytë do të paraqes karakteristikat kryesore të prokurimit publik dhe përfaqësimi i tyre në kuadrin ligjor. Për sa i përket legjislacionit do të shikojmë ligjet e para që janë miratuar dhe ndryshimet e tyre gjatë kohës që është parë e nevojshme përshtatja e tyre. Rëndësinë, kompetencat dhe detyrat e tyre për pjesën e hartimit, zbatimit dhe procedurave të prokurimit. Këto institucione kanë kompetencat e tyre për sigurimin e mosdiskriminimit, paanshmërisë dhe konkurrimit në mënyrë të barabartë e të ndershme.

Kapitulli i tretë paraqet direktivat e para të dhëna nga BE për prokurimin publik në mbarvajtjen e legjislacionit dhe zbatimit nga ana e autoriteteve kontraktuese. Shqipëria ka

përshtatur dhe rregulluar legjislacionin e prokurimit publik me direktivat e BE-së, rruga që ka ndërmarrë shteti me mënyrat e implementimit. Raportet e BE-së për vijueshmerinë e punës që ka kryer Shqipëria gjatë vitit të fundit për zbatimin e direktivave. Të gjitha instrumentet ligjore dhe financiare të përdorura në fushën e prokurimeve publike dhe koncesionëve, duke përfshirë marrëveshjet ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta për zbatimin të projekteve të përbashkëta, duhet të respektojnë parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimi.

Kapitulli i fundit shfaq e-prokurimin, sistemin online për procedurat, ofertat dhe aplikimin e tyre për çdo tender të dhënë nga autoritete kontraktuese. Ky sistem shfaq një rëndësi të madhe në shtetin shqiptar pasi është marrëdhënie kyçe për vazhdimin në mënyrë sa më të saktë dhe të shpejtë të procedurave. Impaktin e teknologjisë në kontratat dhe boshllëqet e nevojshme të cilat kanë nevojë për rregullim do të jepen në këtë kapitull.

KAPITULLI I : PROKURIMI PUBLIK

1.1 Prokurimi publik.

Prokurimi publik është procesi me të cilin Autoritetet Kontraktore dhe organizatat e sektorit publik blejnë mallra, shërbime ose punë nga operatorë ekonomik ose nga kompanitë private duke shfrytëzuar fondet publike¹. Është një aspekt thelbësor i operacioneve të qeverisë dhe mund të ketë ndikime të rëndësishme në ekonomi, financat dhe cilësinë e shërbimeve publike. Duke filluar që nga shtrimi i një rruge, ndërtimin e një shkolle publike, blerjen e materialeve teknologjike për autoritetet publike ose shërbimet e pastrimit kryhen nga procesi i prokurimit publik duke bërë përzgjedhjen e ofruesve me anë të ofertës. Ky është një proces që kryhet nga administratat shtetërore duke i shërbyer në mënyrë direkte dhe indirekte qytetarëve, të cilët janë në të njëjtën kohë edhe taksapaguesit e këtyre shërbimeve. Me anë të këtij procesi autoritetet shtetërore i delegojnë një kontraktuesi privat të drejtën për të kryer aktivitete kryesisht teknike për llogari dhe për emër të autoritetit shtetëror, si për shembull ndërtimi i një stacioni energjik i cili është i domosdoshëm për mirëmbajtjen e energjisë elektrike. Ky lloj delegimi është i bazuar me anë të një kontrate bilaterale ku autoriteti shtetëror duhet të ndjekë rregullat e prokurimit publik.

¹ LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017, Ligjin Nr.103/2018.

1.2 Roli i prokurimit publik.

Duke u bazuar në mënyrën sesi prokurorimi publik është mund ta mendojmë si një zinxhir të përbërë nga nëvoja e një shërbimi ose punë (në mënyrë direkte për Autoritetin Kontraktues dhe në mënyrë indirekte për qytetarët), një burim financiar (fonde publike të ardhura të krijuara nga mënyra të ndryshme pagesash nga qytetarët) administratori i një nevoje dhe zbatuesi (Autoriteti Kontraktues) dhe përfituesi direkt ose indirekt i shërbimit (qytetari). Prokurorimi publik i referohet situates së cilës qeveria (qoftë ajo lokale ose qendrore), ose autoritete publike kryejnë marrëveshje(blerje) me palën private. Këto “blerje” bëhen me synimin që qeveria duhet të kryejë për të siguruar shërbimet publike, pra kryhen në menyrën e përvetësimit për konsumin publik. Këto karakteristika të prokurimit publik reflektohet në dy elemente esenciale: “nëvoja publike” dhe “fondi publik”. Elementi i nevojës publike e bënë procesin e prokurimit më sensitiv² duke e bërë natyrshëm të nëvojshme rregullimin me anë të legjislacionit të këtij procesi. Zgjedhja e një operatori ekonomik pa e konsideruar optimizimin e çmimit dhe kualitetit, në fund të procesit të prokurimit, mund të çojnë në kosto për buxhetin e shtetit.

1.2 Rëndësia e prokurimit publik.

Prokurimi publik ka një rëndësi madhore në Shqipëri, pasi luan rol kyç në zhvillimin e ekonomisë, në transparencën e vendimarrjes në pushtetin qendror si dhe në infrastrukturën e modernizuar me planimetri bashkohore. Përsa i përket impaktit ekonomik, prokurimi publik përfaqëson një pjesë të rëndësishme të GDP në Shqipëri, duke e ndihmuar qeverinë shqipëtare të arrijë qëllimet sociale dhe makroekonomike. Një sistem efektiv i prokurimit publik kontribuon në një menaxhim më të mirë të fondeve publike. Është një mekanizëm strategjik për objektiva ekonomike dhe sociale, arsye kjo që edhe BE i jep rëndësi më të madhe në pjesën e transparencës,efikasitetit dhe mosdiskriminimit. Prokurimi publik siguron që qeveria të mundet t'i dergojë shoqërisë shërbimet bazike publike siç janë edukimi,zhvillim i infrastrukturës,sigurisë publike si dhe kujdesin shëndetësor. Në mënyrë sesi do te menaxhohen fondet do të bëhet garantimi më i mirë i kualitetit për këto shërbime,punë dhe materiale. Përsa i përket zhvillimit të infrastrukturës Shqipëria po kalon një periudhe shumë të rëndësishme tranzicioni në rruge,ura,godina publike dhe ndertesave qeveritare. Në mënyrë që të rritet kualiteti i jetesës qytetarëve Prokurimi Publik është thelbesor për ndarjen në mënyrë sa me korrekte të këtyre projekteve.

1.3 Problematikat e Prokurimit Publik

² Është vlerësuar se 10-30% e investimit në një projekt ndërtimi të financuar nga publiku mund të humbasë nga keqmenaxhimi dhe korrupsioni (CoST, 2014).

Duke vëzhguar nga prespektiva i objektivave afatgjate, shumë progres ngelet akoma për tu bërë në situatën aktuale të prokurimit publik. Shumë raporte nga kerkime shkencore, nga media dhe sektore jo-qeveritare shpesh hasin korrupsion, që është edhe shkaku kryesor më problematik në këtë fushë, pasi pengon zhvillimin dhe keqpërdorjen e fondeve publike që varen nga prokurimi.

Sipas legjislacionit shqiptar objektivat kryesore në prokurimin publik janë konkurrimi në kushte të barabarta, akses i një trajtshëm, mos-diskriminimi si dhe transparencë. Synimi kryesor është garantimi i dërgimit në mënyrë optimale i të mirave publike, shërbimeve dhe punës në kualitetin dhe çmimin më të mirë. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) identifikon një numër të madh sfidash që cenojnë funksionimin në menyrë korrekte të prokurimit publik:

- Ndryshimet e shpeshta të ligjit për prokurimin publik,
- Interpretimi i ndryshëm i ligjit nga personat civilë,
- Probleme në institucionet që nuk vendosin një plan me buxhet limit
- Mungesa e ekspërimit në procedurën e tenderit (ndryshime në staf, mungesa e trajnimit dhe ekspërinces (kriteri teknik) si dhe përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik).
- Mospërshtatshmëria dhe papërgatitja, janë dobësi të zakonshme që lidhen me vonësat e përgjithshme në hapat e ndryshëm të procesit të prokurimit. Ato ndonjëherë mund të rrezikojnë funksionimin e institucioneve të sektorit publik dhe aftësinë e tyre për të përmbushur detyrat e tyre, qoftë në afat të shkurtër, duke ndikuar në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, qoftë në afat të gjatë – si vonësa në përfundimin e investimeve kapitale.
- Përdorimi i procedurave të negociatave të drejtpërdrejta. Kjo vlen shpesh në situata ku ndodhin vonësa dhe autoritetet detyrohen të nisnin “procedurat emergjente” për të vazhduar punën. Procedura të tilla karakterizohen nga mungesa e transparencës dhe në përgjithësi janë me më pak kosto efektive dhe me cilësi më të ulët,
- Anullimi i tenderave lind kur ankesat bëhen nga ofruesit që nuk kanë fituar dhe autoritetet detyrohen të anulojnë tenderin për gabime procedurale. Kjo dobësi mund të tregojë veçanërisht mungesën e transparencës në proces dhe dështimin e sistemit për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë ofruesit e mundshëm,
- Raporti kosto/cilësi nuk arrihet gjithmonë, ky është një efekt tipik i një sistemi joefikas prokurimi dhe ka pasoja të padëshiruara në buxhetet e institucioneve që tashmë janë duke luftuar për të balancuar anën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në fushat që përfshijnë shërbime të drejtpërdrejta për qytetarët – siç është kujdesi shëndetësor, kjo mund të shkaktojë dështime në përmbushjen e nevojave të qytetarëve, krijimin e listave të gjata të pritjes, etj.

Korrupsioni në prokurimet publike është shqetësues. Në një studim të këtij viti, të mbështetur nga Komisioni Europian dhe të realizuar nga SELDI (South-East Europe Leadership for Development and Integrity) ku analizohet mjedisi i korrupsionit në rajon, konstatohet që "në Ballkanin Perëndimor prokurimet publike paraqesin një zonë rreziku të lartë për korrupsion, pasi ato përdoren jo vetëm për të prokuruar mallra dhe shërbime për përfitim publik por shpesh për të

transferuar fonde publike në “xhepa privatë.”³ Antikorrupsioni në përgjithësi dhe në prokurimet publike në veçanti është sfida që duhet fituar nëse Shqipëria këmbëngul të përparojë në procesin e pranimit në BE, pasi ato përbëjnë kritere thelbësore në këtë proces.

Mbështetja e pranisë së OSBE-së për institucionin e KLSH është pjesë e përpjekjeve më të gjera për forcimin e kapaciteteve, transparencës dhe llogaridhënies së sistemit të prokurimeve publike në Shqipëri, që kjo të ndodhë përveç vullnëtit politik nëvojiten kapacitete dhe infrastrukturë adekuate në raport me rëndësinë e këtyre sfidave. Matja e rreziqeve të korrupsionit përmes treguesve të saktë është baza për të ndërmarrë çdo veprim për ta luftuar atë dhe siguruar një administratë më të mirë publike.

Kapitulli II. Karakteristikat kryesore të prokurimit publik.

2.1 Karakteristikat e Prokurimit Publik.

Kuadri ligjor. Prokurimet publike në Shqipëri qeverisen nga ligji Nr. ligji Nr.9643 “Për prokurimet publike” I cili është miratuar në vitin 2000 dhe vazhdimisht është amenduar më pas për ta përfaqësuar me direktivat e BE-se për prokurimin publik. Ligji vendos rregullat, procedurat dhe parimet që udhëheqin gjatë procesit të prokurimit.

Procedurat e Prokurimeve. Shqipëria ndjek procedura të ndryshme të prokurimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- **Procedurat e hapura:** Çdo operator ekonomik i interesuar mund të dorëzojë një ofertë të caktuar për një njoftim publik.
- **Procedurat strikte:** Vetëm operatorët ekonomik të parapërzgjedhur janë të ftuar të dorëzojnë oferta.
- **Procedurat të nëgociuara:** Autoritetet kontraktore negociojnë me një ose më shumë operator ekonomik.

³ <https://www.dw.com/sq/tiran%C3%AB-osbe-p%C3%ABr-transparenc%C3%AB-dhe-llogaridh%C3%ABnie-antikorrupsion/a-59393937>

Dialog konkures: Përdoret për projekte komplekse ku autoriteti kontraktor zhvillon dialog me operator ekonomik të përzgjedhur për të zhvilluar zgjedhje të ndryshme.

Kufijtë: Ligji jep kufi financiar që përcaktojnë procedurën e zbatueshme të prokurimit. Prokurimet nën kufijtë e caktuar mund të kryhen përmes procedurave të thjeshtsuara ndërkohë që kërkohen procedura më të gjëra dhe më konkurruese për prokurimet mbi këtë kufi.

Transparenca dhe E-prokurorimi: Shqipëria ka punuar me rritjen e transparencës dhe efikasitetit në prokurimin publik nëpërmjet zbatimit të sistemeve të prokurimit elektronik. Sistemi elektronik i prokurimit publik lehtëson dorëzimin elektronik të ofertave, aksesin e informacionit të lidhur me prokurimin dhe menyrën e thjeshtësimit të këtij procesi.

Konkurenca dhe paanësia. Prokurimi publik në Shqipëri synon të promovojë konkurrencën midis operatorëve ekonomik dhe siguron paanësinë në procesin e përzgjedhjes. Ligji balancon rregullat për të parandaluar diskriminimin dhe të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë ofruesve.

Konsiderimi social dhe mjedisor. Ligji lejon dhe marrjen parasysh të kriterëve sociale dhe mjedisore gjatë procesit të prokurimit. Përfshin promovimin e pjesëmarrjes në ndërmarrjet e vogla dhe mesatare duke konsideruar impaktin që kanë në mjedis vendimet e prokurimeve.

Sfidat. Si çdo shtet tjetër, dhe Shqipëria haset në sfida, që përfshijnë problemet transparencën, korrupsionin dhe efikasitetin. Përpjekje të vazhdueshme janë bërë për ti përballuar këto sfida për përmirësimin e sistemit gjithëpërfshirës me prokurimin publik.

2.2 Kuadri Ligjor i Prokurimit Publik

Kuadri ligjor

Legjislacioni në fushën e prokurimit publik është i përbërë nga ligji nr.9643, më datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”⁴, i amenduar si vendim nr.914, më datë 29.12.2014 nga Këshilli i Ministrave “Për aprovimin e rregullave të prokurimit publik”, i amenduar.⁵ Këto instrumente ligjore janë të bazuara në direktivat 2004/18.EC, “Për koordinimin e procedurave të prokurimit për kontratat e punës, mallrave dhe shërbimeve” (direktivat e sektorit publik),⁶

Direktivat 2004/17/EC “Për koordinimin e procedurave të prokurimit publik që operojnë në energji, ujë, transport dhe shërbime postare në sektorin e shërbimit”⁷, të cilat janë shfuqizuar nga direktiva të reja të 2007/66/EC nga Parlamenti Europian dhe nga Këshilli Europian më

⁴ <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5a6fa8ae-6fec-48bc-bdf1-bc419c0b4734>

⁵ https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendim_nr._914_.pdf

⁶ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32014L0024>

⁷ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=CELEX%3A32004L0017>

11 Dhjetor 2007 i amenduar 89/665/EC i referuar për rritjen e efikasitetit për rishikimin e kontratave publike dhe procedurave të kryera.

Gjithashtu legjislacioni në fushën e prokurimit përmban dy vendime të Këshillit të Ministrave, i cili rregullon prokurimin e përqëndruar në nivel qeverie, vendimi nr.82⁸, në date 14.02.2018, “Krijimin ,organizimin dhe funksionimin e agjencisë shtetërore të prokurimeve të përqëndruara dhe ngarkimin e kësaj agjencie për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucionëve të varësisë” dhe vendimi nr 81⁹ më date 14.02.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë shtetërore të prokurimeve të përqëndruara”.

Fusha e prokurimit publik përfshin gjithashtu edhe prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, i cili rregullon me anë të vendimeve të Këshillit të Ministrave çdo instruksion për secilin nga institucionet shtetërore. Me finalizimin e ligjit për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, aprovimin e së cilës e kryu Asambleja në Prill 2020. Këto lloj prokurimesh do të jenë të rregulluara me direktivat 2009/81/EC¹⁰ për prokurimet në këtë fushë. Në mënyrë që ligji të jetë plotësisht i aplikueshëm, është e nevojshme që të kryhet adoptimi dhe përshtatshmëria në periudha tranzitore.

2.3 Institucionët përgjegjës për këto fusha janë:

- **Agjencia e Prokurimit Publik (APP)**
- **Komisioni i Prokurimit Publik (KPP)**
- **Ministria e Financës dhe Ekonomisë**
- **Ministria e Mbrojtjes**
- **Ministria e Punëve të Brendshme**
- **Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP)**
- **Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara (ASHPP)**

- **Agjencia e Prokurimit Publik** është institucioni politik-bërës në fushën e prokurimit publik në Shqipëri dhe disa nga detyrat kryesore përfshijnë masat rregullatore, verifikimin legjitimitetin e

⁸ <https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-9-qershor-2022/>

⁹ <https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-9-qershor-2022/>

¹⁰ <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2009:216:0076:0136:en:PDF>

sistemit të prokurimit, përgatitjen e dokumentave të tenderave, asistimin në kapacitetin e operatorëve ekonomik në procedure publike. APP është një institucion buxhetor nën mbikqyrjen e Këshillit të Ministrave. Shtrirjen edhe detyrat në mënyrë më të hollësishme janë në ligjin nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i amenduar.¹¹ Kompetencat dhe detyrat e APP janë më së shumti të fokusuar në:

- Përgatitjen e propozimeve për rregullimin e prokurimit publik, ankandeve publike dhe ato në fushën e koncesioneve publike/private, përgatitjen e dokumentave të tenderit dhe duke vënë në dukje instruksionet e nevojshme në mënyrë që të asistojë në organet kontraktuese që ti ndërmarrin këto veprime,
- Verifikimin e implementimit të prokurimit publik, ankandet publike dhe procedurat e koncesioneve mbas fazës së firmosjes së kontratës, në rastet kur bëhet shkelje e dispozitave ligjore dhe nënligjore bën ndeshkimin me gjobë dhe propozon masat administrative,
- Monitoron progresin e sistemit të prokurimit publik dhe kryen implementimin e aktiviteteve, masave për të mbajtur një sistem sa më efikas dhe transparent kundrejt palëve në proces,
- Përgatitjen dhe publikimin e njoftimeve në Buletinin e Prokurimit Publik, siç është përshkruar në rregullat e prokurimit,
- Në përputhje me kërkesën jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi,
- Paraqet një raport vjetor në Këshillin e Ministrave për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik,
- Bashkëpunon me institucionet ndërkombëtare dhe me ente të tjera të huaja për çështje që lidhen me marrëveshjet e kryera me palë të huaja,
- Promovimin dhe organizimin e qendrave të trajnimit lokal dhe qendror në zyrat e qeverisë që janë të ndërlidhura me aktivitetet e prokurimit publik,
- Harton dhe përshtat rregulloret e saj të brendshme.

Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarisht nga çështja penale, që mund të ketë fituar për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet n.q.s bëhet keqinformimi dhe dorëzimi i dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme me qëllime kualifikimi për marrjen pjesë në mënyrë ilegale në tendera ose ankande të përcaktuara nga kjo agjenci. Si dhe dënimin në rast të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontrata publike në 3 vitet e fundit.

- **Komisioni i Prokurimit Publik** është administrata më e lartë për rishikimin e ankesave në fushën e prokurimit. KPP-ja është një institucion i pavarur, anëtarët e të cilës zgjidhen nga parlamenti, u ndjekur nga një procedurë selektive të drejtuar nga Këshilli i Ministrave dhe i raporton në parlament. KPP-ja rishikon ankimet për procedurën e prokurimit, konkurimin për

¹¹ https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Ligji-PP-_nr-_9643_date_20_11_2006_i-ndryshuar_22.pdf

konçesionët,PPP-t dhe lejet.¹² Në veprimtarinë e tij Komisioni respekton parimet e ligjshmërisë , barazisë dhe mosdiskriminimit, paanshmërisë në shqyrtimin e ankesave,si dhe informimin e publikut. Ky komision përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe 3 anëtarë të cilët gëzojnë statusin e nënpunësit civil. Kompetencat e kryetarit janë thelbësore në veprimtarinë e Komisionit pasi miraton aktet e nevojshme mbi organizimin dhe mbarëvajtjen e punës së punonjësve nën ngarkim, përfaqeson Komisionin në marrëdhënie me të tretët si dhe përgatit projektbuxhetin vjetor të Komisionit. Në marrëdhëniet me të tretët bashkëpunon me autoritetet shtetërore duke ruajtur pavarësinë dhe autonominë e tij, kërkon informacion nga Agjencia e Prokurimit Publik si dhe merr pjesë aktivisht në organizata ndërkombëtare¹³.

➤ **Agjencia e Trajtimit të Konçesionëve** është një institucion nën Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe detyra kryesore është të sigurojë asistencë në Autoritetet Kontraktore në konçesione publike dhe partneritetin publik-privat . Detyra të tjera si zhvillimin e procedurave në unifikimin e standarteve të dokumentacioneve për konçesionë/PPP. Kompetencat e ATK janë të gjendura në ligjin 125/2013¹⁴ “Për konçesionet dhe partneritetin publik-privat” i amenduar. Nën kompetencën e Ministrisë së Ekonomisë ATK-ja është e ndarë në:

- **Nivelin strategjik** ku bëhet asistimi i koncesioneve në mënyrë transparente duke siguruar një qasje të barabartë dhe profesionale nëpërmjet Autoriteteve Kontraktuese.
- **Nivelin e projekteve** ku bëhet asistimi dhe këshillimi i autoriteteve kontraktuese në konsiderimin edhe vlerësimin e ofertave kundrejt projekteve të koncesioneve sidomos në hemisferën e përfitimit dhe fizibilitetit, negocimit nëpërmjet palëve në marrëveshje,organizimin e trajnimeve dhe dokumentave përkatëse për implementimin e projekteve.

Monitorimi i kontratave është një aspekt thelbësor për menaxhimin efektiv të projekteve, por shpesh has vështirësi,veçanërisht në fondet e sektorit privat. Një nga vështirësitë kryesore në këtë fushë është edhe mungesa e transparencës dhe llogaridhënies. Subjektet në sektorin privat nuk kanë gjithmonë si prioritet monitorimin strikt të kontratave, gjë që sjell keqmenaxhimin e burimeve dhe çështje të mundshme ligjore. Për të zbutur këto vështirësi,agjencia duhet të investojë në programe trajnuese për stafin e tyre në mënyrë që të ndërlihen me monitorimin e kontratave. Këto programe mund t’i pajisi me aftësi dhe njohuri te nevojshme për t’i dhënë zgjidhje efektive të kontratave komplekse.

➤ **Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara** është një institucion buxhetor nën Ministrinë e Brendshme dhe funksionon si një trup qendror për blerjet e zyrave të Kryeministrit,ministrive dhe institucionet e varura. ABP-ja kompetencat i ka të bazuara në ligjin nr.81 datë14.02.2018 “Për stabilizimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara”, dhe ligji nr.82 datë 14.02.2018 “Për autorizimin e Agjencisë për procedurat e prokurimit publik, për emër dhe për llogari të zyrës të kryeministrit,ministrive dhe institucionet e varura, për të mira material dhe shërbime”. Kjo agjenci në rastin kur kryen procedura prokurimi:

¹² <https://kpp.al/BlogArticle?id=587>

¹³ file:///C:/Users/Dell/Downloads/VendimKPP.pdf

¹⁴ <https://www.app.gov.al/legjislacioni/koncesionetppp/ligji/>

- **Për nënshkrimin e marrëveshjeve** zhvillon këtë procedurë deri në momentin e nënshkrimit midis paleve, përlllogarit fondin limit për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen ,shqyrton ankesat e operatorëve ekonomik monitoron zbatimin e kontratave ku nëpërmjet një raporti cilëson korrektësinë ose vonesat që janë bërë në kontratë.
- **Për lidhjen e kontratave** ka detyra dhe përgjegjësi për zhvillimin e procedurave deri në shpalljen e fituesit,bashkërendon punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave,verifikon përputhshmërinë e kërkesave të autoriteteve kontraktuese si dhe përlllogarit fondin limit për përcaktimin e të dhënave sasiore për mallrat dhe shërbimet që prokurohen.¹⁵

➤ **Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara (ASHPP)** në zbatim të VKM nr.393 datë 09.06.2022 “Për krijimin , organizimin dhe funksionimin e agjencisë shtetërore të prokurimeve të përqëndruara dhe ngarkimin e kësaj agjencie për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik , në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësishë”¹⁶ është organi qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në mirëpërdorimin e fondeve publike, nëpërmjet kryerjes së procedurave të përqëndruara të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerën mbi kufirin monetare të prokurimeve të vogla.

ASHPP ka përgjegjësi të organizojë punën për kryerjen e procedurave të prokurimi për të nënshkruar marrëveshje kuadër dhe kryerjen e procedurave të prokurimit për të lidhur kontratë. Kjo agjenci organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë , ku drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i Përgjithshëm për të kryer të gjithë veprimtarinë e agjencisë dhe përgjigjet përpara ministrit. Detyrat kryesore të ASHPP janë:

- Të bashkërendojë punën me autoritetet/entet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, teknike e sasiore,të mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme të unifikuara,
- Të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet/entet kontraktore, në raport me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike,
- Të përlllogarisë fondin limit për sasi të pritshme të mallrave dhe shërbimeve që do të prokurohen në bazë të marrëveshjes,
- Të zhvillojë procedurat e prokurimit deri në nënshkrimin e marrëveshjes,
- Të njoftojë autoritetet/entet kontraktore për mundësinë lidhjes së kontratës brenda afatit të përcaktuar në marrëveshje.

¹⁵

https://mb.gov.al/wpcontent/uploads/2018/02/VENDIM_PËR_KRIJIMIN_ORGANIZIMIN_DHE_FUNKSIONIMIN_E_AGJENCISE_Se_BLERJEVE_Te_Përqendruara.pdf

¹⁶<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6892&token=dcbe7d32422ff25eee1cb2921057786f26e18a1b>

Kapitulli III Proçesi i Integrit

3.1 Direktivat

Direktivat e prokurimit publik.

Shqipëria ashtu si shumë vende të tjera dëshiron të bashkohet me Bashkimin European dhe duke punuar me praktikat e prokurimit publik me përshtatjen e standarteve europian dhe direktivave bën të mundur edhe integrimin më të shpejtë në BE. Në mënyrë që t'i bëjmë një vlerësim zhvillimit të sistemit të prokurimit publik duhet të shikojmë pasqyrën historike të direktivave të BE-së. Kjo gjë na jep mundësinë e studimit të qëllimit në sistemin e prokurimit dhe objektivave në fillimet e tyre.

Direktivat e para të prokurimit.

Si një program i përgjithshëm për implementimin e Direktivave u bë aprovimi/miratimi i disa direktivave sic ishte ajo e Liberalizimit dhe Koordinimit. Direktivat e Liberalizimit syonin shfuqizimin e masave kufizuese dhe diskriminuese. Direktivat e Koordinimit synojnë përafrimin e legjislacionit me shtetet anëtare të BE-së me qëllim koordinimin e procedurave të dhënies së kontratave publike.

3.1.2 Direktivat e para të Koordinimit.

Dy direktivat e para të koordinimit ishin përkatësisht : Direktiva 71/305 për kontratat e punës publike dhe Direktiva 77/62 për kontratat e “mira”. Të dy direktivat kishin të njëjtin rregullim në anën ligjore ku shërbimet dhe puna e kontratave trajtoheshin në mënyra të ndara. Në vitin 2004 së bashku me Direktivat 92/50 në lidhje me shërbimet, u konsoliduan në një tekst të vetëm. Direktivat 71/305 u adoptua nga Programet e Përgjithshme pasardhëse me synimin e koordinimit të procedurave (legjislacionit) të brendshëm të Shteteve Anëtare për përzgjedhjen e fituesve dhe dhënien e kontratave publike. Kjo direktivë rikonfirmon objektivat kryesore të Programeve të Përgjithshme për ndalimin e efekteve diskriminuese , për përcaktimin e kualifikimit teknik dhe vendosjen e kriterëve për pjesëmarrësit si blerës. Direktivat gjithashtu i japin një rëndësi të veçantë implementimit në mënyrë efektive të konkurrimit në sektorin e kontratave publike. Rregullat e traktatit për lëvizje të lirë kanë si detyrim mosdiskriminimin në procedurën e prokurimit publik, e cila është një pikë fillimi për hapjen e rrugës për procedurat e prokurimit publik. Por gjatë kësaj kohe është konsideruar e pamjaftueshme për të hequr barrierat e tregtimit që egzistojnë në marketin publik dhe në mënyrë që të arrihen duhet të konsiderohen gjerësisht detyrimet pozitive dhe kërkesat e transparencës.

Direktivat 77/62 u miratua me qëllimin e koordinimit të procedurave për zgjedhjen e fituesve dhe dhënien e kontratave. Kjo direktivë përveç kërkesës për krijimin e kushteve të barabarta për konkurrencë, thekson transparencën e procesit të prokurimit duke synuar një kontroll të lehtësuar të zbatimit të parimeve të mësipërme. Qëllimi i të dy direktivave ishte që të rriste transparencën në procedurën e prokurimit (duke publikuar të gjithë tenderat në Komitetin e Anëtarëve të Shtetit), nga e cila rrjedhin kontratat publike duke siguruar dhe monitoruar parimin e konkurrencës efektive, e cila sjell mundësi të barabarta dhe akses të barabartë në këto kontrata (duke vendosur kriteret objektive për pjesëmarrje dhe ndalimin e diskriminimit).

3.2 Legjislacioni European dhe prokurimi publik.

Legjislacioni dhe integrimi.

Harmonizimi me direktivat e BE-së : Shqipëria ka përshtatur dhe rregulluar legjislacionin e prokurimit publik me direktivat e BE-së , veçanërisht me Direktivën 2014/24/BE për prokurimin publik dhe Direktivën 2014/25/BE për etnitetet që operojnë në fushën e ujit,energjisë , transportit dhe shërbimeve postare.Këto direktiva vendosin rregulla dhe procedura për prokurimin publik në shtetet anëtare të BE-së.

Proçesi i asosacionit: Shqipëria ka qënë një kandidate për antarësimin në BE dhe si pjesë e proçesit të asosacionit i është kërkuar të bëjë përshtatjen ,rregullimin e ligjeve dhe administratës sipas standarteve të BE-së. Kjo përfshin prokurimin publik, i cili është një komponent thelbësor në tregun e BE.

Transparenca dhe kokurrenca: BE-ja i ka dhënë theks të fortë në legjislacion për sa i përket transparencës dhe kokurrencës së ndershme në prokurimin publik. Përpjekjet e Shqipërisë për përshtatjen e standarteve të BE-së kanë dhënë rezultat dhe përmirësim në këto zona ,duke përfshirë dhe implementimin e nje sistemi elektronik për më shumë informacion,transparencë dhe orientim për proçesin e prokurimit publik.

Proçedurat: Shqipëria ka rregulluar pragun financiar dhe proçedurat e prokurimit për të qënë në linjë me rregullat e BE-së. Kjo siguron që kontratat të përmbajë vlerat e caktuara si të qënit të rregullta të hapura për publikun dhe një procedure me kokurrencë te drejtë.

Parandalimi i diskriminimit : Integrimi i BE-së kërkon që praktikrat e prokurimit të Shqipërisë të përmbahen nga rregullat e mosdiskriminimit. Kjo dmth që operatorët ekonomik nga vendet anëtare të BE-së duhet të kenë të njëjtat të drejta dhe mundësi të barabarta me kompanitë shqipëtare që marrin pjesë në tendera publik.

Kapaciteti i ndërtesave: Shqipëria ka marrë asistencë dhe mbështetje në ndërtesa nga BE dhe organizata ndërkombëtare për të rritur ekspertizën e prokurimit publik. Kjo përfshin trajnimin për prokurimin publik dhe përhapjen e praktikave më të mira.

Monitorimi dhe raportimi: Si pjesë e proçesit të integritetit,Shqipëria është subjekt i monitorimit dhe raportimit në institucionet dhe agjensitë e BE-së, kjo ndihmon në sigurimin se shteti po bën progres është në rrugën e duhur të praktikave dhe zbatimit të standarteve të vendosura nga BE.

Aksesin në fondin e BE: Rradhitja si vendet me mundësi për të hyrë në BE është thelbësore për sa i përket aksesit të fondeve të BE-së duke i siguruar Shqipërisë projekte të financuara nga BE. Shumë nga projektet me fond të BE-së kërkojnë zbatimin sipas rregullave të vendosura nga BE për më shumë theksim në mënyrën sesi këto projekte zbatohen.

Integrimi rajonal: Përpjekjet e Shqipërisë për përafrimin e standarteve të prokurimit të BE-së lehtësojnë gjithashtu integrimin ekonomik rajonal brenda ballkanit perëndimor ndërsa vendet fqinje ndjekin reforma të ngjashme për të përmbushur kërkesat e BE-së.

3.2.1 Planet kombëtare të Shqipërisë në procesin e integritit

Me qëllim përmirsimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, dhe garantimin e mirëpërdorimit të fondeve publike, është ngritur një grup punimi 2020-2023 për të hartuar një draft për Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik dhe për planin e veprimit.

SKPP 2020-2023 synon të garantojë një sistem prokurimi eficient dhe efektiv në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lire dhe të ndershme, mos-diskriminimit dhe trajtimit të barabartë si dhe nëpërmjet promovimit të një sistemi të qëndrueshëm të garantohet vlera në para për problematikat kombëtare dhe ndërkombëtare që janë prezente në këto fushë.

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen janë:

- Rritja e transparencës,
- Eficiencë në përdorimin e fondeve publike,
- Planifikim më të mirë të prokurimit publik,
- Përmirësimi i menaxhimit të kontratave,
- Profesionalizimi i funksionit të prokurimit publik
- Përmirësim i kuadrit ligjor,
- Përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit
- Garantimi i procedurave të qëndrueshme të prokurimit publik në respektim të mirëqenies sociale, mbrojtjes së mjedisit etj.¹⁷

Në shqipëri në fushën e prokurimeve vërehet një dukuri specifike. Në përpjestim të drejtë, sa më shumë përmirësohet baza ligjore e prokurimit publik, aq më shumë rritet numri i procedurave speciale që anashkalojnë këto përcaktime të prokurimit, si me ligje të veçanta ashtu edhe me vendime të Këshillit të Ministrave. Ligji “Për prokurimin publik” është një ligj i vlerësuar nga faktorët vendas, faktorët ndërkombëtar dhe vetë organizmat e Bashkimit Europian si një ligj i mirë në përputhje me standartet më të mira në këtë fushë. Për pasojë sfida mbetet implementimi korrekt i tij.

3.2.2 Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë, date 19.10.2021:

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimet publike. Është bërë përparim i mirë, veçanërisht duke miratuar ligjin e ri për prokurimin publik dhe strategjinë e prokurimit publik, pas konsultimeve të gjera publike. Nëvojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar përputhshmërinë me procedurat dhe për të parandaluar korrupsionin në ciklin e prokurimit. Rekomandimet e Komisionit nga viti 2020 u zbatuan kryesisht. Rekomandimi për kapacitet

¹⁷ <https://www.app.gov.al/dokumenta-p%C3%ABr-konsultim/konsultim-mbi-draft-strategjin%C3%AB-komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-prokurimin-publik-2020-2023-dhe-planin-e-veprimit/>

adekuat administrativ është reflektuar në strategjinë e prokurimit publik 2020-2023 dhe tani kërkon ndjekje.

Shqipëria duhet të:

- të miratojë legjislacionin e mbetur për zbatimin e ligjit të ri të prokurimit publik;
- të zhvillojë dhe zbatojë sistemin elektronik të menaxhimit të kontratave dhe regjistrin elektronik të ankesave për përmirësimin e monitorimit dhe transparencës;
- të sigurojë që kushtet e marrëveshjeve ndërqeveritare, të lidhura me vendet e treta, të jenë në përputhje me kërkesat e acquis, veçanërisht në fushën e prokurimit publik.

Të gjitha instrumentet ligjore dhe financiare të përdorura në fushën e prokurimeve publike dhe koncesionëve, duke përfshirë marrëveshjet ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta për zbatimin të projekteve të përbashkëta, duhet të respektojnë parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimi.

APP-ja aplikon një sistem monitorimi për të vlerësuar performancën e prokurimit, pajtueshmërinë dhe zbatimin e kontratës. Në vitin 2021, në përputhje me ligjin e ri, autoritetet i paraqitën APP-së planet e zbatimit të kontratave të nënshkruara. Sistemi elektronik i menaxhimit të kontratave, që mbulon ciklin e plotë të kontratave, është duke u pilotuar. Autoritetet kontraktore vazhdojnë të ndërtojnë kapacitete për të menaxhuar prokurimin publik. Këto procese duhet të jenë në përputhje me ligjin e ri përmes trajnimit të më shumë zyrtarëve në autoritetet kontraktore se në vitin e kaluar (1 555 persona të trajnuar në 2021 krahasuar me 970 në 2020).

Në lidhje me integriteti dhe konflikti i interesave, APP nxori udhëzime për shpalljen e konflikteve me interes nga zyrtarët e prokurimit dhe miratoi një rregullore për parandalimin e konflikteve të interesi për ushtrimin e funksionëve publike në APP.

Kapitulli IV Sistemi elektronik i prokurimit publik.

4.1 E-prokurim

Sistemi Elektronik i Prokurimit Publik (SEPP) në Shqipëri është një platformë e disenjuar për të lehtësuar dhe drejtuar në mënyrë më efektive në procesin e prokurimit publik. Është një komponent jetësor për modernizimin e praktikave të prokurimit në Shqipëri, rritjen e transparencës dhe bashkëveprimin me standartet e BE-së. Në kuadrin e reformës të plotë të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri për rritje të transparencës dhe luftën kundër korrupsionit, Agjencia e Prokurimit Publik në mbështur nga Programi i Marrëveshjes Për Sfidat e Mijëvjeçarit me komponent “Reforma në Prokurimin Publik”, i menaxhuar nga USAID, vendosën një sistem elektronik për prokurimin publik.

Sistemi u implementua për here të pare në Shqipëri në vitin 2008, u konsiderua si një faze testi ku një numër i limituar të vendosur nga Autoritetet Kontraktuese, të cilat kishin kapacitete

teknike dhe kapacitete administrative u përzgjedhën për testimin e sistemit. Kjo fazë dha sukses pasi u arrit që të bëhej reduktimi i kostos, rritje të numrit të ofertave dhe transparencë të njoftimeve për ofertat. Pas disa përmirësimeve në sistem në vitin 2009 Këshilli i Ministrave vendosi që të gjithë Autoritetet Kontraktuese në Shqipëri, duhet që të gjithë procedurën e prokurimit ta kalojnë në sistemin e e-prokurimit. Sistemi lejon të gjitha procedurat e prokurimit të performohen elektronikisht, përveç procedurës të “negocimit pa publikim paraprak”. Sistemi i ri ofron një treg elektronik, duke lejuar furnizuesit për të bërë ofertat e tyre, të shohin progresin e tenderit dhe informacionet e kontratës së dhënë. Sistemi ofron një përgatitje të sigurt, transparente dhe efikase për heqjen e dokumentave fizike administrative në mënyrë që procesi të jetë më i shpejtë në mënyrën elektronike. Të gjithë dokumentat e tenderave nga njoftimi për tender deri në finalizimin e kontratës janë të disponueshme në sistemin e prokurimit publik.

4.1.1 Impakti i sistemit elektronik të prokurimit publik.

Ndikimet e kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, ka qenë vërtet i mirë dhe pozitiv edhe në këndvështrimin e Autoriteteve Kontraktuese, në krahasim me procedurat e prokurimit të bazuara në letër. Para së gjithash është më pak i kushtueshëm, pas shmangies së letrave të tepërta. Sistemi elektronik i prokurimit publik lejon mirëmenaxhimin e hapësirës së dedikuar të tenderit, zvogëlon kohën e aplikimit dhe eliminon dokumentet e panevojshme. Duke u krahasuar me procedurat e mëparshme të kryera në mënyrë fizike me anë të dokumentave është konstatuar një komunikim më i shpejtë dhe efikas nëpërmjet autoriteteve kontraktuese dhe furnizuesve.

Nga ana tjetër, nëpërmjet publikimi të këtyre procedurave, të gjithë operatorët ekonomik kanë mundësinë të informohen në mënyrë koherente për të gjithë ofertat e dhëna në portal që janë në favorin e tij. Duke shkarkuar të dhënat e tenderit operatorët ekonomik kanë mundësinë të bëjnë zgjedhjet e tyre për çdo ofertë dhe të gjitha dokumentacionet e kërkuara për një marrëveshje të barabartë me operatorë të tjerë ekonomik.

Shkurtimi i procedurave të prokurimit publik dhe kohës së nevojshme, është ulur në mënyrë të konsiderueshme krahasuar nga sistemi i mëparshëm me dokumentacione.

Përdorimi i sistemit të e-prokurimit redukton shancet e korrupsionit. Kontaktet individuale nëpërmjet operatorëve ekonomik që kanë një interes në një tender të caktuar, shmang marrëveshjet e fshehta që mund tq kryhen. Nga ana tjetër duke kryer procedurat përmes sistemit, eventualisht shmang kontaktet individuale të zyrtarëve dhe ofertuesve të autoriteteve kontraktore, duke reduktuar mundësinë e veprimeve korruptive.

4.1.2 Përmirësimet e nevojshme për sistemin e-prokurimit.

- ✓ Parandalimi i vonesave në transmetimin me database të sigurt,
- ✓ Rritjen e kapaciteteve teknike në ngarkimin e dokumentave,
- ✓ Sigurimin e konfidencialitetit të informacionit,
- ✓ Rritjen e parametrevave të lidhjes së internetit,
- ✓ Teknologji inovative,
- ✓ Menaxhimin të hapësirës së sistemit, duke siguruar edhe vazhdimin e punës,

- ✓ Parametrat e kërkuara për lidhjen e internetit (E-prokurimi është nje sistem i bazuar në web,kështu qe lidhja e internetit duhet të jetë në shpejtësinë më të lartë,qëndrueshmëri në lidhjen e internetit etj,. Kjo gjë është e nevojshme për një komunikim interaktiv dhe në kohe reale nëpërmjet Autoriteteve Kontraktuese, nëpërmjet operatoreve ekonomik dhe nëpërmjet sistemit në vetvete).
- ✓ Një tjetër çështje kyç që ndihmon për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit është kuadri rregullator. Implementimi i sistemit elektronik duhet të shoqërohet me një rregullator, që shpjegon në detaje të gjitha rolet e përfshira gjithashtu të gjithë hapat që duhet të ndjekin gjatë kryerjes së nje procedure¹⁸.

KONKLuzionet

Direktivat e BE-së për Sektorin e Prokurimit Publik dhe ligji Shqiptar për Prokurimin Publik kanë natyra të ndryshme dhe objektiva të ndryshme. Ligji për Prokurimin Publik është një ligj kombëtar që synon të rregullojë sistemin e prokurimit publik në Shqipëri ndërsa direktiva e BE-së janë ligje ndërkombëtare , të cilat synojnë të rregullojnë sistemin e prokurimit publik brenda në BE, duke dhënë instruksione shteteve anëtare ti zbatojnë në mënyrat e kërkuara këto politika.

Objektivat kryesore e BE-së për direktivat kanë qënë krijimi i një tregu të përbashkët i cili eleminon barrierat për të tregtuar shërbimet dhe të mirat material ndërmjet shteteve anëtare të BE dhe jo vetëm. Duke e krijuar një treg të përbashkët të prokurimit bëhet edhe heqja e të gjithë barrierave në mënyrë që të krijohet një sistem ku përfituesi kryesor të jetë vetë publiku që

¹⁸ <https://www.ippa.org/IPPC5/Proceedings/Part2/PAPËR2-5.pdf>

paguan taksat , të jenë operatorët ekonomik të cilët bëjnë një garë të drejtë dhe të barabartë si dhe mirëmenaxhimi i fondeve publike nga ana e shtetit.

Të pasurit ligje të forta për financimin e shërbimeve publike, standarde të larta etike në shërbimin civil, barazi në marrjen pjesë në tendera, një nivel të kënaqshëm të mirpërdorimit të burimeve dhe ekspertizës teknike si dhe informacion transparent mbi organet kontrolluese të nëpunësve civil apo zyrtarëve të zgjedhur të ngarkuar me prokurimin publik, ligje më të forta anti- korrupsion do të kontribuonin në prokurimin publik. Ku procedurat dhe rezultatet do ishin me fitimprurëse në rast të zbatimit të këtyre ligjeve sipas kërkesave të Bashkimit European dhe reduktimin e përhapjes së korrupsionit në prokurimet publike.

Në funksion të arritjes së këtij qëllimi:

- ✓ Duhet të përmendet se zbatimi i ligjeve anti-korrupsion apo të konkurrencës nga organet administrative nuk duhet të jetë i pavarur nga zbatimi i ligjeve kundër korrupsion nga Agjencitë Ligjzbatuese (zakonisht të besuara tek organët antikorrupsion dhe gjyqësore). Shkëmbimi sistematik i informacionit midis agjencive zbatuese dhe investigimet e përbashkëta janë masa shumë të rekomanduara në realitetin shqiptar. Në veçanti duket me vend të hapet sistematikisht një investigim konkurrues mbi tregjet e prokurimit për të cilat janë gjetur prova korrupsioni.
- ✓ Duhet të harmonizojmë më mirë zbatimin e ligjeve të ndryshme në Shqipëri që rregullojnë marreveshjet e operatoreve ekonomik dhe Autoriteteve Kontraktuese në menyre qe konkurrenca, ofertat e tenderave dhe menaxhimi i fondeve publike te behen në menyre sa me transparente dhe efikase.
- ✓ Duhet të shmangim ndryshimet e shpeshta në legjislacionin për prokurimet frekuenca e ndryshimeve të ligjit. Ky është një mësim i së kaluarës. Pavarësisht se ka shumë skeptikë për këtë gjë, ndryshimet e shpeshta duhet të eliminohen dhe të gjithë procesit të ligjberës duhet t'i sigurohet transparenca dhe gjithëpërfshirja.
- ✓ Menaxhim me i mire i sistemit online për shpalljen e ofertave, fituesve pasi nga kjo gje përfitohet shërbim me i mire por edhe konkurrenca me e barabarte. Nga sistemi online i prokurimit shfaqen shume rradhet, shmangen dokumentat e panëvojshme te panumerta dhe nje rregullim sistematik i ketij sistemi do te beje rrjedhshmerine e punes pa pengesa.

Shqipëria ka përveç bazës së nevojshme ligjore ka të plotësuar edhe kuadrin strategjik në prokurime nëpërmjet strategjisë përkatëse 2020-2023. Në këtë strategji përcaktohen në mënyrë të qartë objektivat dhe rrugët që do të ndiqen për zhvillimin e kësaj fushe dhe të operatorëve të përfshirë deri në fund të vitit 2023. Mbetet sfida realizimi i saj dhe veçanërisht ndjekja e të gjithë hapave dhe plotësimit të detyrave në kohë. Prokurimi publik është një prej aspekteve të jetës dhe realitetit shqiptar. Ndaj ai i nënshtrohet njëloj rregullave të përgjithshme të vlerësimit që bëhen sot për shtetin dhe shoqërinë shqiptare. Dhe në rrugën e integritit evropian ka një fjali të përsëritur dhe që në rrugëtim është bërë postulat “Keni ligje të mira, por sfidoheni në zbatimin e tyre”. Ndaj edhe zbatimi i drejtë dhe i plotë i ligjit, prokurimi publik këtu i përfshirë, mbetet çelësi i një rrugëtimi të suksesshëm evropian të Shqipërisë.

REFERENCAT

- Agjencia e Prokurimit Publik , *Ligjet* [e-prokurimi online],
- DW - *Artikull për korrupsionin në Shqipëri* [online],
- Vendimet e Këshillit të Ministrave,
- EUR-Lex *Directive 2014/24/EU of the European Parliament and of the Council of 26 February 2014 on public procurement and repealing Directive 2004/18/EC Text with EEA relevance,*

- EUR-Lex *Directive 2009/81/EC of the European Parliament and of the Council of 13 July 2009,*
- Komisioni i Prokurimit Publik *,Krijimi i Rrjetit të Organeve Shqyrtuese të Prokurimit Publik të Evropës Juglindore,*
- Ministria e Brendshme *, Vendimi për krijimin,organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara,*
- Agjencia e Prokurimit Publik, *Njoftim Nr. 3658 Prot., datë 12.06.2020,*
- Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë, date 19.10.2021